

VENDIM
Nr. 92, datë 13.5.2019

**PËR MIRATIMIN E NJË NDRYSHIMI NË RREGULLOREN “MBI KRITERET
DHE PROCEDURËN PËR NGRITJEN NË DETYRË TË PROKURORËVE PRANË
PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË
ORGANIZUAR”**

Në mbështetje të neneve 148/dh dhe 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 47, 48 dhe 163, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 164, pika 8 dhe 189, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe neneve 2, 7, 12 dhe 57, të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Në nenin 14, pika 2, të rregullores “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, shprehja “brenda 6 javëve nga mbledhja e parë”, zëvendësohet me shprehjen “brenda 9 javëve nga mbledhja e parë”.

2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Ibrahimi